



**Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit**



01/Nr. 3419/2021  
Data: 11.05.2021

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e katërt -IV- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 20.04.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Durim Dernjani (Menaxher i Projekteve), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Kërkesë për plotësimin e vendimit 01/Nr.2996/2019 për pëlqimin në parim për studimin e potencialit ujorë në komunën e Hanit të Elezit.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi thekson:-** përveç pikave të cilat i kemi paraparë në agjendë i kemi edhe një material shëtitës, Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës. Për pikën shëtitës dhe për rendit e punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Kërkesë për plotësimin e vendimit 01/Nr.2996/2019 për pëlqimin në parim për studimin e potencialit ujorë në komunën e Hanit të Elezit.
6. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës.
7. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- raporti është përgatitur sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësitë. Përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse janë rritur të hyrat vetanake , a janë të hyra që janë rritur për shkak të performancës dhe efikasitetit të punës që po bëhet këtu apo janë inkasuar nga borxhet e viteve të kaluara.

**Shabi Rexhallari** thekson:- rritja e të hyrave vetanake është në shumë prej 4960.24 € e më tepër ka të bëjë me tatimin në pronë që qytetarët kanë pasur borxhe dhe disa kanë hyrë në kontratë me vetë dëshirë.

**Teuta Shkreta** thekson:- kërkoj sqarim më të hollësishëm për çështjen e kontratës.

**Shabi Rexhallari** thekson:- kontrata bëhet varësisht prej borxhit të cilin e kanë dhe e paguajnë me këste.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTUA RAPORTI FINANCIARË PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **3. Informatë për ndarjen e bursave.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- në material janë të paraqitura në detaje dokumentacionet dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Teuta Shkreta** thekson:- studentja që është në punë dhe është përjashtuar nga marja e bursës unë mendojë që e ka rolin e studentet pavarësisht se ajo se është në punë është studente.

**Menduh Vlashi** thekson:- në kuvend është miratuar rregullorja për ndarje e bursave dhe përcaktohet se në qoftë se studenti punon nuk i takon bursa.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa ka qenë numri i aplikuesve për bursë.

**Menduh Vlashi** thekson:-në material janë të përcaktuara të gjitha të dhënat.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTUA INFORMATAT PËR NDARJEN E BURSAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- përvëç materialeve të cilat i kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ishin disa kontrata të reja dhe numri i përgjithshëm i kontratave ishte 1405. Në kuadër të kompanisë janë tre shoferë dhe a është mundësisë që me pasur një shtesë që me qenë edhe punëtorë teknik edhe shoferë, sepse në disa vende punojnë edhe shoferë edhe punëtorë teknik por merr mjete financiare shtesë për punën që e bënë. E potencova këtë në mënyrë që mos me ngarkuar kompaninë me shpenzime.

**Kujtim Dernjani** thekson:- kjo çështje është pak problem sepse punëtori teknik e kryen punën e vetë dhe shoferi e kryen punën e vetë . Punëtorët të cilët e bëjnë zbrazjen e kontinierëve bëjnë edhe pastrimin e deponive të ndryshme, ndërsa shoferi nuk besoj që shkon.

**Refet Kalisi** thekson:- pajtohem me z.Mehmet Ballazhi me atë që potencojoë por ne kemi shkuar në atë aspekt për shkak se i kemi zgjeruar punët.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA INFORMATA PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2021 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **5. Kërkesë për plotësimin e vendimit 01/Nr.2996/2019 për pëlqimin në parim për studimin e potencialit ujorë në komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Durim Dernjani** thekson:- është dhënë pëlqim në vitin 2019 potencialit ujorë në komunën e Hanit të Elezit por është dhënë në parcelën 1204-1 zona kadastrale në Seçishtë dhe kjo është bërë me kërkesë të kompanisë, mirëpo në Ministri ka bërë kërkesa për servitut me shfrytëzuar pjesën e hapësirës ujore dhe ata ka vërejtur që në pjesën e poshtëm për shkak se më herët e ka pasur për pjesën lartë. Kompania po e kërkon në anën e poshtme por nuk është definitive për shkak se me lejen ndërtimore e përcakton saktë ku me vendosur. Nga vendi i quajtur shkuma e tezoshtë është numër tjetër i parcelës, ndërsa në shkumë e përpjetë është tjetër numër i parcelës. Ministri e kish pajisur me dokumentacion në pjesën nér shkumën për shkak se kompania do të merr edhe pëlqime të tjera por edhe prej neve ka kërkuar pëlqim që me dal në pjesën e poshtme. Për me ju dhënë leje duhet të ndërrohet numri i parcelës në mënyrë që me ju dhënë leja saktë dhe tash a duhet me plotësim të vendimit apo me marr vendim tjetër që mendoj që kuvendi vendos. Nëse është e nevojshme në mbledhje të kuvendit të komunës mund ta ftojmë përfaqësuesin e kompanisë për sqarime.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në dokumentacion shihet që kishte marr shumë pëlqime , mirëpo ne kemi dhënë pëlqim parçë dy viteve për hidrocentral dhe me sa kam informata duhet brenda dy viteve kompania me i pas filluar punimet. Unë mendoj që duhet të bëhet kërkesë për me i dhënë pëlqim të ri për shkak se ligji e precizon dhe nuk na lejon me bërë plotësim. Kompania ka kërkuar që në vendin e quajtur nér shkuma me i dhënë pëlqim por duhet ta dimë se edhe z.Nexhmedin Kuka e ka biznesin aty dhe duhet ta shikojmë se a i bënë pengesë në mënyrë që mos me pasur probleme në të ardhmen. Si kuvend asnjë herë nuk ja kemi ndaluar askujt dhënien e pëlqimeve dhe çdo investorë që ka dashur me punuar i kemi dhënë pëlqim. Përfaqësuesi i kompanisë në kuvend e ka prezantuar kërkesën dhe si asamblistë i kemi pasur kërkesat dhe shqetësimet tonë që kemi me dhënë pëlqim po ndoshta nuk do ti filloni punët dhe kemi kërkuar se çka përfiton komuna prej projektit në fjalë.

**Kryesuesi** thekson:- parafolësi i potencoje çështjet se nëse është për me bërë ndryshim duhet të bëhet për shkak se kërkesa me përbajtjen nuk përputhet sepse këtu është vetëm plotësim e realisht duhet me bërë të ri. Për me bërë ndryshim kuptohet se është kërkesë e vjetër, mirëpo me dhënë pëlqim të ri mënyra dallon. Çdo herë kemi dhënë pëlqime në parim dhe askujt nuk i kemi penguar dhe kjo kompani në kuvendin e komunës ka premtuar shumë, por skeptik kemi qenë prej në fillim dhe po shihet se asgjë nuk ka bërë dhe po dyshojë që sikur me na mashtruar se ndoshta donë me ndryshuar e në emër të ndryshimit donë me përsërit kërkesën. Drejtoria duhet ta specifikon se a japim pëlqim të ri apo ndryshim.

**Durim Dernjani** thekson:- nuk besoj që paraqet problem për biznesin që e ushtron z.Nexhmedin Kuka por unë mendoj që do të i shtohet puna për shkak se do të bëhet si një lloj liqeni dhe do të jetë i shfrytëzueshëm për shkak se ka me pasur akumulim të ujit ku do të vendosen turbinat dhe do të jetë i detyruar për me pasur një kanal për lëvizjen e lirë të peshqve. A ka qenë arsyja e kompanisë për me zgjatur vendim për arsy që nuk e ka nisur brenda afatit dy vjeçar por kjo nuk është hera e parë sepse edhe hidrocentralet e tjera të cilët kanë pasur e ju ka skaduar për arsy se nuk kanë mundur me i marr vendimet nëpër institucionet e tjera të nivelit qendrorë. Nëse e ndërtton edhe një hidrocentral te ajo pjesa që është te treni që është vendosë besoj që ishte bërë edhe një qendër rekreative. Kompania ma dha një shembull siç e ka ndërtuar në Mitrovicë dhe besoj që do të bëhet mirë si shëtitore.

**Refet Kalisi** thekson:- a ka ndonjë objekt që vendoste në atë pjesë sepse ne e kemi një projekt për rregullimin e Lumit Lepenc dhe unë mendoj që ka me ja humbur pamjen Lumit Lepenc nëse vendoset objekti.

**Durim Dernjani** thekson:- objekti ka me u vendosë dhe kompania siç ka potencuar se pamje nuk ja humbë lumit Lepenc.

**Kryesuesi** thekson:-unë jam që kompani me parashtruar kërkesë të re dhe jo plotësim ndryshim dhe pastaj e diskutojmë dhe e japim pëlqimin sepse nuk jemi kundër.

**Mallzum Qajani** thekson:- pëlqimin e ka kompania dhe donë me ndërruar lokacioni dhe nuk bëhet fjalë për shtim të numrave por për zhvendosje në disa metra më poshtë, mirëpo për ndryshe vendimi është sepse është miratuar në kuvend. A është shënuar shifra gabim apo e ka kërkuar pjesën përmbi dhe tash po e kërkon përfundim unë nuk po e di këtë punë por bëhet fjalë për parcelë që është disa metra më lartë dhe kompania e kërkon disa metra më poshtë , a skorenspodonë me Ministrinë e Ambientit, a skorenspodonë me vendimin tonë nuk po e di por si pëlqim e kemi dhënë si kuvend dhe nuk duhet të ngatërohen gjërat. Nëse kompania ka parashtruar kërkesë për me bërë hidrocentralin e ri atëherë është dashur me u proceduar lëndën që kompania po kërkon pëlqim të ri.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë që të konsultohemi me zyrën ligjore për këtë çështje dhe duhet të konsultohemi se a bien ndesh me planin rregullativ.

**Kryesuesi** thekson:- ne nuk jemi kundër por është mirë që kompania të paraqet kërkesë të re dhe mos me potencuar ndryshim të vendimit sepse është duke ndërruar lokacionin. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri kundër.

**NUK U VOTUA KËRKESA PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01/NR.2996/2019 PËR PËLQIMIN NË PARIM PËR STUDIMIN E POTENCIALIT UJORË NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR ME U PËRCJELL PËR KUVEND**

## **6. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- materialin e keni para vetës, komisioni ka dal në vend ngjarje dhe ka hartuar raportin që parcela i plotëson kushtet për shkak se është në zonën e planit zhvillimorë që mund me ndërtuar.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA KËRKESA E SOKOL LOKU PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **7. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në ora 12:09

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

